



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 19 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, nenit 36 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtar Publikë, nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Rregullores Nr. 03/2022 për Praktikantë në Sistemin Prokurorial lidhur me procedurën për rekrutim të praktikantëve vullnetarë pa pagesë, për periudhën një (1) vjeçare në sistemin prokurorial të Kosovës, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpallë këtë:

V A Z H D I M I K O N K U R S I T
Nr. 01/2024

Për praktikantë vullnetarë pa pagesë, për periudhën një (1) vjeçare, si në vijim:

Nr.	NJËSIA	Numri i Praktikantëve
1.	Sekretariati i KPK-së	3
2.	Prokurori e Apelit	5
3.	Prokuroria Themelore Prishtinë	20
4.	Prokuroria Themelore Pejë	12
5.	Prokuroria Themelore Ferizaj	10
6.	Prokuroria Themelore Prizren	10
7.	Prokuroria Themelore Gjilan	10
8.	Prokuroria Themelore Mitrovicë	6
9.	Prokuroria Themelore Gjakovë	4
10.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihme Viktimave-Prishtinë	2
11.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihme Viktimave- Gjilan	1
12.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihme Viktimave- Ferizaj	1
13.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihme Viktimave- Pejë	1
14.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihme Viktimave- Gjakovë	1
15.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihme Viktimave- Prizren	1
16.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihme Viktimave- Mitrovicë	1
	GJITHSEJ:	88

Detyrat kryesore të praktikantit/es:

- Ndihejmon prokurorët si dhe stafin e sistemin prokurorial në kryerjen e detyrave si dhe kryen punë të tjera në koordinim me zyrtarët e prokurorisë dhe Sekretariatit të KPK-së.
- Përbahet rregullave të brendshme të sjelljes, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në vijueshmëri, orarin e punës, kodin e veshjes dhe konfidencialitetin.
- Në përputhje me legjislacionin në fuqi duhet të gëzojnë të drejtën për pushim ditor, pushimin vjetor, festat zyrtare dhe mbrojtjen nga orët e tepërta të punës.
- Praktikanti duhet të ketë mundësinë që të aftësohet në aspektin profesional në kuadër të detyrave dhe përgjithësive të cilat i janë ngarkuar.
- Përgatitjen e raportit gjashtë mujor dhe në fund të praktikës, ose sipas kërkesë së mbikëqyrësit me angazhimet e kryera.
- Kryen edhe detyra tjera të caktuara nga prokurori dhe zyrtarët e sistemit.
- Përjashtimisht praktikantët të cilët janë të fushave tjera, siç janë praktikant në financa, teknologji informative, administratë, burime njerëzore si dhe shërbime të tjera të përgjithshëm detyrat përcaktohen nga udhëheqësit e njësive përkatëse brenda Prokurorit të Shtetit dhe në Sekretariatit të KPK-së sipas nevojës.
- Për punën e tyre praktikantët në Sekretariatit mbikëqyren nga udhëheqësit e njësive, ndërsa në prokurori nga administratori i prokurorisë.

Kualifikimi:

- Diplomë Universitare - Fakulteti Juridik, përjashtimisht për praktikantë në Sekretariatit të KPK-së Diplomë e Fakultetit Ekonomik, Fakulteti Juridik apo Administratë publike.

Aftësitë dhe Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri të procedurave administrative, etj.;
- Aftësi për përgatitjen e akteve juridike;
- Aftësi të punës me kompjuter;
- Shkathtësi komunikimi.

Dokumentet për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit;
- Diploma apo certifikatë universitare;
- Certifikata e gjendjes penale.

VËREJTJE:

- Konkursi është vazhduar shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes së lajmërimit më datën: **08.05.2024** dhe mbyllet me datë **14.05.2024**.
- Kandidatët praktikantë duhet të plotësojnë formularin standard për aplikim që është dispozicion në ueb faqen e KPK-së: www.prokuroria-rks.org.

Forma e aplikimit:

- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë punë nga ora 08:00 deri në ora 16:00 në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës/Departamenti i Burimeve Njerëzore kati IV, Rr. "Luan Haradinaj", Objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, 10000 Prishtinë
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Departamentin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të

Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj" objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

- Aplikacionet pas skadimit të afatit të konkursit të lartë cekur nuk pranohen.